

L I G J
Nr.8476, datë 14.4.1999

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË QËNDRIMIT TË FORCËS GREKE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 12 pika 3 e 83 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.8264, datë 18.12.1997 “Për ratifikimin e marrëveshjes plotësuese për protokollin e ndihmës dhe të bashkëpunimit të forcave të armatosura ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare të Greqisë”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Afati i qëndrimit të Forcës Greke në Shqipëri, me status dhe përbërje të përcaktuar në ligjin nr.8264, datë 18.12.1997, zgjatet deri më 25.9.1999.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2354, datë 30.4.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani